



**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

Operatorit Ekonomik “InfoSoft Office” shpk

Adresa: Tirane Kashar Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur** (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti II** "Materiale Kancelarie të tjera zyre", **me Nr. REF-12943-07-11-2024** për nevoja të Autoriteteve Kontraktore përfituese Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Akademia e Forcave të Armatosura.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e dytë do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës/kontratave brenda marrëveshjes kuadër nga Autoritetet kontraktore përfituese.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 37 datë 15 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

• **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k**

NUIS J62426002Q

Vlera e ofertës pa tvsh = 1,630,580.30 (*një milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë pikë tridhjetë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k,** **NUIS K81503063B**

Vlera e ofertës pa tvsh = 1,670,000 (*një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Vlera e ofertës pa tvsh = 1,269,220 (*një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k** **NUIS J72124001N**

- Vlera e ofertës pa tvsh = 900,876 (*nëntëqind mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s`kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Për arsyet e mëposhtme:

Në vijim, në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht *në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

MO=1,630,580.30+1,670,000+1,269,220 = 1,523,266.76

PR = 85 % Mo = 1,294,776.75

Nga përlllogaritja rezultoi se oferta ekonomike me vlerë **1,269,220** (*një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet*) lekë pa TVSH, paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k., me NUIS L91418502J është anomalisht e ulët.

Për rrjedhojë dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, *Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”*, Operatori Ekonomik s`kualifikohet.

- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k** **NUIS J72124001N**

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave datë 29.07.2024, nuk ka paraqitur mostrën me nr.35 (Evidenciator), e cila duhet të jetë në përputhje me specifikimet e DST.

Mos paraqitja e mostrave është kusht për s`kualifikim, për rrjedhoje operatori ekonomik s`kualifikohet.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues** ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm i identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit është:

- **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k**

NUIS J62426002Q

Vlera e ofertës pa tvsh = 1,630,580.30 (*një milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë pikë tridhjetë*) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.